



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA RREGULLATORE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 6242 prot.

Vlorë, më 23.04 2025

Lënda: Informacion mbi problematikat e konstatuara nga emergjencat civile dhe masat e marra për përmasimin e gjendjes.

KËSHILLIT TË BASHKISË

Vlorë

Misioni që ka Drejtoria e Mbrojtjes Civile për realizimin e detyrave synon në krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë dhe për tu rimëkëmbur, nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi përbëjnë elementet kryesor që përshkojnë planin për të bërë të mundur shfrytëzimin e të gjitha mundësive dhe kapaciteteve ekzistuese.

Plani i Mbrojtjes Civile për Bashkinë Vlorë është i zbatueshëm për të gjitha fazat e ciklit të emergjencave, për përgatitjen, përgjigjen, rikthimin në gjendje normale dhe lehtësimin e pasojave në popullsi.

Sipas eksperiencës në vite Bashkia Vlorë vlerësohet si një rajon i mundshëm për një numër të konsiderueshëm fatkeqësish natyrore ose veprimtaria njerëzore. Rreziku më i madh në Bashki nga fatkeqësitë natyrore mund të vijë nga tërmete të rëndë, përmytjet, rrëshqitjet e tokës.

Baza ligjore ku mbështetet puna e D.M.C është ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe VKM Nr. 329 data 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Për periudhën 01.01 2024 - 31.12.2024 D.M.C ka verifikuar rreth 45 ankesa qytetarësh që kanë të bëjnë me problematika të ndryshme.

Disa prej ankesave kanë qënë djegje në banesë nga shkaqe të ndryshme të cilat janë verifikuar më pas u janë plotësuar dosjet me dokumentacionin përkatës duke bërë të

• mundur dëshmipërblimin financiar nga Bashkia Vlorë.

Në periudhat e rreshjeve me intensitet të lartë kemi hasur me problematika si shkarja e dherave dhe të inerteve, ku sëbashku me Ndërmarrjen e Shërbimeve është bërë e mundur hapja dhe qarkullimi i mjeteve.

Erërat e forta dhe stuhitë e erës kan sjellë problematike me rënien e pemëve duke bllokuar rrugët, si në zonën e Orikum-Dukat si dhe në pyllin e sodës. Në bashkëpunim me Drejtorin e Pyjores është bërë e mundur prerja e pemëve dhe hapja e rrugës.

Për vitin 2024 D.M.C në bashkëpunim me M.Z.SH, Ndërmarrjen Pyjore dhe Policinë Bashkiake kemi hartuar Planin e Masave për Parandalimin e Zjarreve për periudhën pranver-verë 2024.

Në bazë të planit D.M.C ka zhvilluar takime sensibilizuese në Qendrat Administrative Orikum, Novosel, Qëndër dhe Shushucë.

Në këto takime ka pas përfaqësues nga Policia e Shtetit, Ndërmarrja Pyjore, M.Z.SH, si dhe Kryeqendrat e Fshatrave.

Në datë 01.07.2024 mbasë marrjes së njoftimit për zjarr në zonën e Radhimës specialistët e D.M.C shkuan me urgjencë në vendin e zjarrit dhe në bashkëpunim me M.Z.SH bënë të mundur fikjen.

Datë 04.07.2024 rreth orës 16:30 u morrë njoftim për zjarr në zonën e Llogorasë pjestarët e D.M.C shkuan dhe në bashkëpunim me M.Z.SH, Zonat e Mbrojtura dhe me Ndërmarrjen e Pyjores u bë e mundur vënia në kontroll dhe fikja e zjarrit rreth orës 01:00 dhe deri në orët e para të mëngjesit u mbajtë në kontroll nga M.Z.SH dhe D.M.C

Në datë 25.07.2024 ora 14:58 Drejtoria e Mbrojtjes Civile mori njoftim për vatër zjarri në vend-grumbullimin e mbetjeve të qytetit nga shërbimet zjarrëfikse me anë të telefonit. Në orën 15:00 specialistët e Drejtorisë së Mbrojtjes Civile të Bashkisë Vlorë shkuan në vend, u konstatua se zjarri kishte përmasa të mëdha dhe situata ishte tepër e rëndë për shkak dhe të erës së fuqishme e cila ndihmonte përhapjen e zjarrit dhe vërshtirsonte punën për fikjen e tij. Në vend ishin duke punuar 3 mjete zjarrëfikse me personelin përkatës (10 veta) si dhe 2 mjete të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Volvo me zinxhir dhe fadroma e madhe me goma. Duke qënë se zjarri kishte përmasa të mëdha situata ishte e rëndë dhe nuk mund të përballohej vetëm nga shërbimet zjarrëfikse, personeli i Emergjencave Civile si dhe mjetet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, u vendosë të kërkohej ndihmë tek bizneset që ushtrojnë aktivitetet në qytetin e Vlorës.

Në vend-grumbullimin e mbetjeve rreth orës 18:00 erdhi z.Taulant Duka me një mjet me zinxhir sëbashku me manovratorin e tij dhe filluan punën për fikjen e zjarrit. Ndërkohë nga firma 2A që punon për ndërtimin e aeroportit të Vlorës erdhën 4 kamiona vetëshkarkues dhe 1 mjet me zinxhir. Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Vlorë filluan punën dhe 2 kamiona 1 me dy akse dhe 1 me katër akse si dhe 2 skrepa me goma të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike. Rreth orës 20:00 mbasi u riparua me urgjencë filloi punën buldozieri i madh me zinxhir i z.Vladimir Deda.

Duke qënë se situata nuk po vendosej në kontroll dhe zjarri po përparonte në fushën e mbetjeve dhe tymi i çliruar nga mbetjet përbënte problem për qytetin u njoftua përgjegjesi i Mbrojtjes Civile në Prefekturë i cili këtë problematikë e raportoj në Drejtorin e Përgjithshme të Mbrojtjes Civile të cilët i bënë kërkes Forcave të Armatosura për eskavator me zinxhir dhe kamiona.

Rreth orës 24:00 në zonën veri-perëndim të mbetjeve zjarri morri përmasa të mëdha dhe rrezikoheshin banesat që ndodheshin aty pranë. Në këtë zonë u instaluan menjëherë 2 mjete zjarrfikse të cilat për rreth 1 orë bënë të mundur uljen e zjarrit dhe largimin e rrezikut nga banesat. Për të garantuar sigurinë e banesave gjatë natës aty u qëndrojë 1 mjet zjarrfikës për të eliminuar ndonjë përhapje të mundshme të zjarrit.

Datë 26.07.2024 rreth orës 06:30 filloi përsëri puna për fikjen e zjarrit ku përveç mjeteve që filluan punën në datën 25.07.2024 erdhën në ndihmë 2 kamiona vetshkarkues të firmës Hanxhari si dhe 4 kamiona vetshkarkues dhe 1 traktor i madhë me zinxhir i firmës Ankor. Në datë 26.07.2024 u mbajt kontakt me mjetet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe u bë i mundur shoqërimi i tyre pranë pikës së mbetjeve rreth orës 18:00, të cilët përbëheshin nga 2 kamiona vetshkarkues dhe 2 buldozier me zinxhira. Në ndihmë erdhi dhe 1 mjet zjarrfikës i Alpetrol Fier si dhe 2 auto-bote të ujësjellsit përkatësisht 16 dhe 7 ton ujë secili. Nga firma Salillari erdhën dhe 3 mjete të cilët sollën material inert që u përdorën për stabilizimin e rrugës ku kalonin mjetet e tjera. Puna vazhdoi deri në orën 23:00 dhe qëndroj 1 mjet zjarrfikës në gatishmëri për ndonjë rrezik të mundshëm.

Datë 27.07.2024 ora 07:00 filloi përsëri operacioni për fikjen e zjarrit dhe kthimin në normalitet të situatës. Përveç mjeteve që punuan gjatë datës 25 dhe 26 korrik u shtuan 1 kamion dhe 1 skrep me goma nga Ministrisë së Mbrojtjes, po kështu nga bizneset që operojnë në qytetin e Vlorës u dërguan 2 kamiona vetshkarkues nga z.Ardian Skëndaj si dhe 2 kamiona të tjerë nga z.Flamur Isufi. Nga zoti Agron Hysenaj u sollën 6 kamiona vetshkarkues me inerte të cilat u përdorën për sistemin e rrugës për të kaluar mjetet, po kështu nga firma Alb-Son u sollën 2 kamiona me lënd inert.

Megjithëse me kushte tejet të vështira, temperatura e lartë dhe tymi toksik i çliruar nga mbetjet, të gjithë personat dhe strukturat e angazhuara të Bashkisë Vlorë, në ndihmë erdhi dhe 1 zjarrfikës i Alpetrol Fier dhe bizneset që operojnë në Bashkinë Vlorë punuan me intesitet të lartë dhe punë e pandërprerë duke bërë që zjarri të vihej në kontroll dhe vatra e zjarrit të zvogëlohej së tepërmi si dhe reja toksike të zvogëlohej në maksimum.

Datë 28.07.2024 ora 07:30 filloi përsëri puna me të gjitha mjetet e ndodhura dhe të ardhura në ndihmë për fikjen e zjarrit të cilave ju shtuan dhe 4 mjete nga z.Elidon Xhaferri. Ka vazhduar mbushja dhe shpërndarja me inerte nga fadromat dhe kamionat për të bërë të mundur izolimin e plotë të vatrave të zjarrit dhe të tymit. Puna vazhdoi pa ndërpreje deri në orën 20:00.

Datë 29.07.2024 ora 07:00 rifilloi puna për mbylljen përfundimtare dhe izolimin e plotë të vatrave të zjarrit dhe të tymit. Gjatë gjithë ditës u operua për kapsulimin e vatrave të zjarrit me dhera dhe inerte të cilat vazhduan pa ndërprerje gjithë ditën.

Në orën 18:15 vatra e zjarrit u mbyll, rreth orës 20:00 mjetet e ardhura në ndihmë u larguan nga pika e mbetjeve.

Në pikën e mbetjeve qëndroi 1 mjet zjarrfikës në gatishmëri për çdo situatë që mund të ndodhi.

Datë 30.07.2024 ora 08:00 mjetet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, mjetet e Ministrisë së Mbrojtjes si edhe 3 mjete nga kompania A2 vazhduan punën për të bërë kapsulimin e plotë të vatrave të vogla që mund të kishin mbetur si dhe depozituan material inert në fushën e mbetjeve me qëllim vazhdimin e punës për të shmangur çdo lloj aktivizimi të vatrave sa do të vogla që mund të ishin.

Në orën 14:00 mjetet e Ushtrisë si dhe mjetet e kompanisë A2 u larguan nga pika e mbetjeve. 2 skrepat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe manovratori i firmës Duka sëbashku me mjetin e tij janë duke punuar për normalizimin e situatës dhe mbajtjen në kontroll.

Gjithë ky operacion i vështirë për fikjen e zjarrit dhe kthimin në normalitet tek vend-grumbullimi i mbetjeve u ndoq nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha, Zv/Kryetari Klevis Kaso si dhe nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Policia Bashkiake me të gjitha strukturat përkatëse.

Situatë problematike për qytetin e Vlorës u krijua në datën 04.10.2024 nga rreshjet e dendura të shiut të rëna në një kohë të shkurtër.

Rreth orës 14:00 datë 04.10.2024 në territorin e Bashkisë Vlorë filluan rreshjet e shiut me intensitet mesatar të cilat erdhën duke u shtuar dhe vazhduan me intensitet shumë të lartë të cilat vazhduan rreth orës 17:30 duke sjelle problematika të medha në qytet.

Nga informacioni i marrë nga Shërbimi Meteorologjik Ushtarak u njoftuam që në këtë hark kohor kanë rënë rreth 180mm shi, sasi kjo e barabartë me rreshjet e një muaji në periudhën e dimrit.

Bashkia Vlorë kishte bërë njoftim të hershëm për marrjen e masave nga qytetarët për përballimin e situatës që mund të krijohej nga rreshjet e tepërta të shiut.

Për përballimin dhe menaxhimin e problematikave të krijuara në orën 17:00 nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha u mbledh komisioni i emergjencave civile, anëtarët e të cileve morën detyrat përkatëse dhe filluan punën në terren.

Në dispozicion të qytetarëve u vendosën dhe numrat e emergjencës për të kontaktuar dhe për tu ardhur në ndihmë në raste nevojë.

Të gjitha strukturat e Bashkisë si Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Shërbimeve, Policia Bashkiake, Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe M.Z.SH dolën në terren me gjithë burimet njerëzore dhe mjetet në dispozicion.

Mjetet zjarrfikëse, policia bashkiake, specialistet e Drejtorisë së Mbrojtjes Civile si dhe strukturat e tjera të Bashkisë filluan evakuimin e familjeve që rrezikonin përmbajtjen.

Janë evakuar 33 familje me 58 persona nga të cilet 13 persona janë strehuar në konviktet e qytetit ndërsa pjesa tjetër janë strehuar tek familja e tyre.

Në operacionin për evakuimin kanë marrë pjesë dhe 4 mjete Jeep të Guardia Di Finanza.

Në orën 19:30 në Prefekturë u mbledh Komisioni i Mbrojtjes Civile të Qarkut ku u raportua për situatën e krijuar nga rreshjet, u raportua zbatimi i detyrave të lëna nga Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e orës 17:00 të KVEC.

Në mbledhje morën pjesë dhe përfaqësuesit e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të cilet konfirmuan ardhjen e ndihmës në mjete dhe forca nga Ministria e Mbrojtjes, ndihma përbehej nga 12 forca me 2 motopompa dhe 2 kamiona.

Nga raportimet e bëra nga antëarët e Komisionit të Mbrojtjes Civile të Qarkut rezulton se hidrovolet gjatë gjithë kohës kanë qënë në punë dhe me kapacitet maksimal.

Stacionet kanë punuar në kapacitet të plotë duke vendosur në dispozicion edhe pompat rezervë, edhe pse ka patur shpërndarje të shpeshta të energjisë elektrike kanë punuar me sistemet e emergjencës.

Janë realizuar hapjet në det për disa nga kanalet, si dhe është pastruar në dalje kanali në lundër-mare si dhe pjesa lidhëse me tumbinot.

U ngritën grupet e terrenit në çdo rajon për ndërhyrjen, mbështetje për qytetarët vecanërisht gjatë orëve kur rreshjet ishin me intensitet të lartë dhe një sërë aksesh problematike ishin të bllokuara.

Në datën 05.10.2024 ka vazhduar puna në terren për eliminimin e dëmeve dhe kthimin e gjendjes në normalitet, strukturat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe Ujësjelles Kanalizime kanë vazhduar punën pa ndërprerje që prej datës 04.10.2024.

Përveç forcave operacione dhe mjeteve të Bashkisë Vlorë punojnë 7 bote dhe 2 sonda që kanë ardhur nga Drejtoria e U.K.

Në datën 06.10.2024 vazhdon puna në terren për normalizimin e situatës.

Është vazhduar normalisht me planin e punës për largimin e mbetjeve të kontenerëve dhe jashtë tyre në 5 rajonet e qytetit. (4 kamionçina, 6 mjete teknologjike turni i parë, 6 mjete teknologjike turni 2, 1 mjet teknologjik për Nj. Adm. Orikum, 1 mjet teknologjik për Nj. Adm. Qëndër, 1 mjet teknologjik për Nj. Adm. Shushicë)

Nga FA veprojnë 31 forca 8 motopompa 2 mjete vetshkarkuese dhe 2 fadroma vazhdojnë punën dhe 2 sondat e sjella nga Drejtoria e U.K.

Në datën 07.10.2024 vazhdon pa ndërprerje puna nga të gjitha strukturat e Bashkisë si dhe forcat e ardhura nga M.M për pastrimin e qytetit dhe normalizimin e gjendjes.

Ne baze te urdherit te Kryetarit te Bashkise Nr.410 date 07.10.2024 Nr. prot 15857 grupet e vlerësimit filluan punën ne terren per konstatimin e gjendjes ne banesat e përmbytura nga rreshjet e shiut.

Ne orën 12:00 u mbledhe ne Prefekturë K.M.C ku u diskutua per punimet e kryera, problematikat dhe detyrat ne te ardhmen.

Ne orën 14:00 ne drejtimin e Kryetarit te Bashkise u mbledhe K.V.E.C se bashku me nje grup specialistesh dhe inxhinieresh nga shoqëria civile ku u diskutua per problematikat dhe zgjidhjen afatgjate te tyre.

Nga grupet e vlerësimit ne terren u vlerësuan 143 banesa.

Ne datën 08.10.2024 kane vazhduar punën pa ndërprerje te gjitha strukturat e Bashkise sebashku me forcat e M.M per pastrimin dhe normalizimin e qytetit. Grupet e vlerësimit kane vazhduar punën ne terren dhe kane verifikuar 62 banesa te përmbytura.

Ne orën 21:00 eshte zhvilluar mbledhja ne Kryetarin e Bashkise pjesëmarrës kane qene K.V.E.C dhe eshte raportuar mbi punën e kryer gjate ditës se sotme dhe janë detyra per ditën e nesërme.

Date 09.10.2024 ka vazhduar puna me panderprerje per normalizimin e situatës dhe pastrimin e qytetit, grupet e vlerësimit kane vazhduar punën ne terren dhe kane verifikuar 57 banesa te përmbytura.

Ne datën 10.10.2024 ka vazhduar puna me panderprerje per normalizimin e situatës dhe pastrimin e qytetit, grupet e vlerësimit kane vazhduar punën ne terren dhe kane verifikuar 17 banesa te përmbytura.

Të angazhuar me mjetet e punës për pastrim në qytet ishin 105 punonjës. Kane punuar 31 forca te M.M se bashku me mjetet dhe agregatet e tyre. Ne ore 15:00 u larguan 23 forca te B.M.E.C me mjetet e tyre.

Date 11.10.2024 ka vazhduar puna panderprerje per normalizimin e situatës dhe pastrimin e qytetit, grupet e vlerësimit kane vazhduar punën ne terren dhe kane verifikuar 15 banesa te përmbytura.

Date 14.10.2024 ka vazhduar puna panderprerje per normalizimin e situatës dhe pastrimin e qytetit, grupet e vlerësimit kane vazhduar punën ne terren dhe kane verifikuar 18 banesa te përmbytura.

• Date 15.10.2024 ka vazhduar puna pandërprerje për normalizimin e situatës dhe pastrimin e qytetit, grupet e vlerësimit kanë vazhduar punën në terren dhe kanë verifikuar 5 banesa të përmbytura.

Datë 16.10.2024 ka vazhduar puna pandërprerje për normalizimin e situatës dhe pastrimin e qytetit, grupet e vlerësimit kanë vazhduar punën në terren dhe kanë verifikuar 5 banesa të përmbytura.

Datë 17.10.2024 ka vazhduar puna pandërprerje për normalizimin e situatës dhe pastrimin e qytetit, grupet e vlerësimit kanë vazhduar punën në terren dhe kanë verifikuar 6 banesa të përmbytura.

Gjatë ditëve në vijim ka vazhduar puna për verifikimin e ankesave që kanë paraqitur qytetarët pranë Bashkisë Vlorë.

Datë 22.10.2024 specialistet e Drejtorisë së Mbrojtjes Civile kanë verifikuar shtëpinë e djegur të z.Ornela Sejdiaj në njësinë administrative Orikum.

Specialistët e Drejtorisë së Mbrojtjes civile po plotësojnë dokumentacionin për ta dërguar tek specialistët e Qarkut për të bërë llogaritjen e preventivit përkatës.

Drejtorja e Mbrojtjes Civile po përgatit plotësimin e dokumentave për ti dërguar në Këshillin e Qarkut për dëmshpërblimin e tyre.

Gjatë ditëve në vijim të muajit Tetor deri në datën 31.10.2024 ka vazhduar verifikimi i banesave të përmbytura.

Specialistët e Mbrojtjes civile me grupet përkatëse të ngritura me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Vlorë kanë vijuar verifikimet në banesat e dëmtuara sipas kërkesave të qytetarëve si dhe kanë asistuar në shpërndarjen e pakove ushqimore në familjet e dëmtuara.

Gjatë këtij muaji specialistët e Drejtorisë së Mbrojtjes Civile Vlorë kanë bërë përpunimin e dokumentacionit për dëmshpërblimin e familjeve të dëmtuara.

Gjithashtu është bërë dhe shpërndarja e lavatriçeve dhe televizorëve e shoqëruar sërish me pako ushqimore.

Në datën 26.11.2024 specialistët e Drejtorisë së Mbrojtjes Civile Vlorë përfunduan përpunimin dhe plotësimin e dokumentacionit të banesave të përmbytura dhe janë dërguar në Këshillin e Qarkut për të bërë llogaritjen e preventivave nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë.

Drejtoria e Mbrojtjes Civile Bashkia Vlorë në mbledhjen e Keshillit Bashkiak kaloi për miratim dhe 3 (tre) projektvendime për miratimin e vlerës financiare për dëmet e shkakëtuara në këto 3 (tre) banesa.

Specialistet e Drejtorisë së Mbrojtjes Civile Bashkisë Vlorë në datën 06.12.2024 kanë verifikur 1(nje) ankes te ardhur për 1(nje) banese te djegur te shtetases Z.Margarita Elezi dhe po vazhdon procedura e dokunetacineve.

Në bazë të kërkesave të qytetarëve të ardhura në Bashkinë Vlorë dhe ngritjes së grupit të punës i përbërë nga Kryetarët e Rajoneve, specialistët e Drejtorisë së Mbrojtjes Civile, inspektorët e Drejtorisë së të Ardhura Vendore dhe inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territoriorit,nga Kryetari Bashkisë Vlorë me nr. 410 Prot datë 07.10.2024. Nga grupi u punës u bë konstatimi në terren i dëmeve të shkakëtuara nga përmbytja e datës 04.10.2024. U konsatatuan rreth 375 familje të përmbytura.

Mbas hartimit të procesverbaleve të konstatimit të gjëndjes në banesat e përmbytura të datës 04.10.2024 me shkresë përcjellëse nr.19200 Prot datë 26.11.2024 “Dërgohet dokumentacioni për banesat e përmbytura” në Këshillin e Qarkut për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni ekspertëve.

Me urdhër Nr.526 Date 11.12.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, specialistet e Drejtorisë së Mbrojtjes Civile Bashkisë Vlore po punojnë me ekspertet e Qarkut Vlore per përfundimin sa më shpejt të preventivave të banesave të dëmtuara.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën nr.1871/1 Prot datë 23.12.2024 “Dërgim dokumentacioni për banesat e dëmtuara nga përmbytja” ka dërguar preventivat e hartuar nga komisioni i ekspertëve të qarkut.

Vlera e dëmeve në banesat e përmbytura të datës 04.10.2024 është 56.455.012 (pesëdhjet e gjashtë milion e katërqind e pesëdhjet e pesë mij e dymbëdhjetë) lekë.

Me VKB nr 1 datë 10.01.2025 u bë miratimi i vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja e datës 04.10.2024 në banesat e qytetarëve dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë.

Brënda datës 31.01.2025 përfundoi dhe shpërndarja e ndihmës financiare të aprovuar për banorët e dëmtuar në qytetin e Vlorës.

DREJTOR
Dorian Demiri